



Tiranë më	protdate
Nr.	protnumber

**RELACION**  
**PËR**  
**PROJEKTVENDIMIN**  
**PËR**  
**MIRATIMIN E LISTËS SË DETAJUAR TË DOKUMENTACIONIT QË KËRKOHEM**  
**PËR REGJISTRIMIN E ZGJEDHËSVE QË VOTOJNË JASHTË TERRITORIT TË**  
**REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI**

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja “dh”, të ligjit nr. 10019, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet kompetenca e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projekta me karakter normativ të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për rregullat për regjistrimin e votuesve nga jashtë vendit.

Neni 25, pika 5 e Kodit Zgjedhor parashikon se zgjedhësi për regjistrim në listë paraqet dokumentacionin që vërteton qëndrimin e tij jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Lista e detajuar e dokumentacionit që kërkohet për regjistrimin e zgjedhësve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë përcaktohet me vendim të Rregullatorit.

**II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Ky projektvendim është hartuar në mbështetje të ndryshimeve më të fundit të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim përgatitjen e kushteve dhe zbatimin e masave që mundësojnë votimin nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për zgjedhjet për Kuvend.

Në kreun I të projektvendimit parashikohen rregulla të përgjithshme të përcaktuara në Ligj sa i takon dokumentacionit që paraqet zgjedhësi për regjistrim në listën e zgjedhësve për të vërtetuar qëndrimin e tij jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Në kreun II parashikohen rregullat që lidhen me listën e detajuar të dokumentacionit që kërkohet për regjistrimin e zgjedhësve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Në zbatim

të nenit 25, pika 5 e Kodit Zgjedhor, parashikohet detyrimi i zgjedhësit për të dorëzuar, në këtë rast ngarkuar ngarkuar në Platformën Elektronike të Regjistrimit (referuar si “PER”) gjatë procesit të regjistrimit, një nga dokumentet që vërteton qëndrimin e tij jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Gjatë paraqitjes së kërkesës së zgjedhësit për regjistrim në listën e zgjedhësve jashtë vendit sipas rregullave të miratuara nga Komisioni Rregullator, zgjedhësi ngarkon në Platformën Elektronike të Regjistrimit (PER) të paktën një nga dokumentet e listuar më poshtë që vërteton qëndrimin e tij jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë:

- i. certifikatë pronësie ose dokument ekuivalent në shtetin e rezidencës që provon pronësinë e banesës;
- ii. vërtetim banimi ose dokument tjetër ekuivalent i lëshuar nga organe shtetërore të vendit të rezidencës, ku përcaktohet adresa e banimit.
- iii. kontratë qiraje ose huapërdorje të banesës;
- iv. kontratë kredie për blerje të banesës;
- v. kontratë furnizimi ose faturë të furnizimit me ujë në banesë;
- vi. kontratë furnizimi ose faturë të energjisë (gaz ose elektrike) në banesë;
- vii. kontratë ose faturë të abonimit të shërbimit digjital të transmetimeve audiovizive;
- viii. kontratë ose faturë të ofrimit të shërbimit të internetit/telefonisë fikse në banesë;
- ix. dokument të lëshuar nga organi kompetent i shtetit ku ka vendbanimin, i cili vërteton qëndrimin e zgjedhësit në një institucion shëndetësor, kamp emigracioni, apo tjetër të ngjashëm;

Në zbatim të parashikimeve të nenit 25, pika 6 të Kodit Zgjedhor, të dhënat e identitetit të shtetasit kërkohen të verifikohen nga KQZ në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile dhe nëse ato janë të njëjta, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGjC) bën regjistrimin në RKGjC të adresës që shtetasi deklaroi gjatë procesit të regjistrimit *në një rubrikë të veçantë*.

Në hartimin e këtij projektvendimi për miratimin e listës së dokumentacionit që do të mund të provonte adresën, administrata e KQZ shqyrtoi disa modele të vendeve të rajonit e më gjerë (të listuara më poshtë) për t’u siguruar që lista e dokumentacionit të ishte sa më gjithëpërfshirëse e zgjedhësi të mund të ngarkojë/dorëzojë cilindo nga dokumentet që disponon:

## 1. ITALIA

*Burimi: [Documenti di attestazione di residenza nella circoscrizione consolare – Consolato Generale d'Italia a Nizza \(esteri.it\)](http://esteri.it)*

Për të votuar nga jashtë vendit shtetasit italianë duhet fillimisht të regjistrohen në Regjistrin e shtetasve italianë rezidentë jashtë territorit të Republikës së Italisë (italisht: AIRE). Për këtë qëllim është e nevojshme që çdo herë shtetasi të paraqisë një dokument provues me vlefshmëri deri në 6 muaj.

Konsiderohen të vlefshme këto dokumente:

1. Faturat e furnizimit/shërbimit të utiliteteve (drita, gaz, telefon fiks, internet, tv kabllor) të cilat janë të regjistruara në emrin e shtetasit;
2. Kontrata qiraje në emër të shtetasit;
3. Kontrata pune, apo vërtetime për ndjekjen e studimeve;
4. Deklarim i të ardhurave, apo shkresa zyrtare nga sigurimet shëndetësore, statement të bankës, thesari i shtetit, sindikatë, etj.;

Nuk do të klasifikohen si dokumente të vlefshme vetëdeklarime, apo deklarime strehimi, apo kontrata blerje dhe sigurimi të cilat janë në formë vetëdeklarate nga shtetasi.

Adresa e rezidencës (vendbanimit) duhet të jetë qartësisht e shkruar si e dhënë e marrësit të letrës/dokumenteve (dhe jo vetëm në brendësi të letrës).

Paraqitja e një prove nga dokumentat e sipërcituar është e detyrueshme.

## **2. SPANJA**

Burimi: <https://concordoba.esteri.it/es/servizi-consolari-e-visti/servizi-per-il-cittadino-straniero/cittadinanza/comprobantes-de-residencia/>

Spanja kërkon disa dokumente për të verifikuar adresën e votuesve që jetojnë jashtë vendit. Dokumentet që kërkohen janë:

1. Certifikata e regjistrimit në Konsullatë: Tregon që shtetasi është i regjistruar si qytetar spanjoll që jeton jashtë vendit.
2. Fatura Shërbimesh: Fatura më e fundit për shërbimet në banesë: dritat, gazin, telefonin fiks, internetin ose televizionin kabllor që tregon emrin dhe adresën e saktë të banesës.
3. Kontrata e qirasë ose dokument i pronës: Kontrata e qirasë në emër të shtetasit ose një dokument që vërteton pronësinë.
4. Certifikata e emigrantit: Dokument që vërteton statusin si emigrant në vendin ku jeton e lëshuar nga autoritetet e vendit të rezidencës jashtë (kur aplikohet).
5. Certifikata nga organe të qeverisjes vendore: në disa raste, lëshohet certifikatë nga autoritetet lokale që vërteton adresën e shtetasit.
6. Certifikata/vërtetimi i regjistrimit në regjistrin konsullor: një dokument që tregon se jeni të regjistruar në regjistrin konsullor të Spanjës.

## **3. GJERMANIA**

Burimi: <https://www.bundestag.de/parlament/bundestagsaehl/auslandsdeutsche-213246>

Në Gjermani, për të validuar adresën e votuesve që jetojnë jashtë vendit, kërkohen dokumente të ndryshme që vërtetojnë vendbanimin e tyre, si më poshtë:

2. Fatura shërbimesh: fatura më të fundit për dritat, gazin, telefonin fiks, internetin ose televizionin kabllor që tregojnë emrin dhe adresën e saktë të banesës.

3. Kontrata e qirasë: kontrata e qirasë që vërteton që shtetasi jeton në atë adresë. Kontrata duhet të jetë në emër të tij dhe të përmbajë informacionin e saktë për adresën.
4. Dokumenti i pronësisë: Nëse aplikanti është pronar i pasurisë, një dokument që tregon pronësinë dhe adresën e pasurisë ku jeton.
5. Certifikata nga organe të qeverisjes vendore: një certifikatë nga autoritetet lokale që vërteton adresën e aplikantit. Kjo mund të jetë një certifikatë e regjistrimit të banesës (gjrm. Meldebescheinigung) që tregon se aplikanti është regjistruar në atë adresë.
6. Certifikata nga konsullata: Në disa raste, mund të kërkohet një certifikatë nga Konsullata Gjermane në vendin e qëndrimit që vërteton adresën dhe statusin e aplikantit si shtetas gjerman që jeton jashtë.

#### **4. BOSNJE – HERCEGOVINA**

##### Burimi: KQZ e Bosnje-Hercegovinës

Për të përfunduar aplikimin e zgjedhësit për të votuar jashtë Bosnje - Hercegovinës, votuesi duhet të ngarkojë të paktën një nga dokumentet e mëposhtme, të skanuara ose në një format tjetër të përshtatshëm elektronik, përmes Aplikacionit Elektronik për regjistrimin e votuesve jashtë Bosnjës dhe Hercegovinës:

1. Dëshmia e adresës së saktë jashtë vendit për votuesit që votojnë përmes postës

Dëshmia e besueshme e adresës së saktë jashtë vendit të votuesit, siç përcaktohet në Nenin 3.15, paragrafi (1) i Ligjit për Zgjedhjet në Bosnje – Hercegovinë dhe akt nënligjor të KQZ. Disa shembuj të dokumenteve që pranohen janë:

1. Leje drejtimi e lëshuar nga vendi pritës që përmban adresën;
2. Kartë shëndeti e lëshuar nga vendi pritës që përmban adresën;
3. Vërtetim banimi e lëshuar nga vendi pritës që përmban adresën;
4. Për punonjësit e Ambasadës së Bosnjës dhe Hercegovinës, një certifikatë e nënshkruar nga Ambasadori i Bosnjës dhe Hercegovinës që përmban adresën e banimit ose;
5. Një dokument tjetër i lëshuar nga autoritetet zyrtare të shtetit në të cilin banon.

Në vijim të sa më sipër u konkludua në listën sikundër është propozuar në këtë projektvendim:

- i. certifikatë pronësie ose dokument ekuivalent në shtetin e rezidencës që provon pronësinë e banesës;
- ii. vërtetim banimi ose dokument tjetër ekuivalent i lëshuar nga organe shtetërore të vendit të rezidencës, ku përcaktohet adresa e banimit.
- iii. kontratë qiraje ose huapërdorje të banesës;
- iv. kontratë kredie për blerje të banesës;
- v. kontratë furnizimi ose faturë të furnizimit me ujë në banesë;
- vi. kontratë furnizimi ose faturë të energjisë (gaz ose elektrike) në banesë;
- vii. kontratë ose faturë të abonimit të shërbimit digjital të transmetimeve audiovizive;

- viii. kontratë ose faturë të ofrimit të shërbimit të internetit/telefonisë fikse në banesë;
- ix. dokument të lëshuar nga organi kompetent i shtetit ku ka vendbanimin, i cili vërteton qëndrimin e zgjedhësit në një institucion shëndetësor, kamp emigracioni, apo tjetër të ngjashëm;

### **Bashkërendimi i projektvendimit me palët e interesuara**

Kanë shprehur mendimet e tyre me shkrim në lidhje me këtë projektvendim, Diaspora për Shqipërinë e Lirë, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Qëndresa Qytetare, si dhe zj. Anila Smorgrav përfaqësuese e organizatës së diasporës GERMIN. Nga opinioni i Komitetit Shqiptar të Helsinkit, të ardhur me shkresën me nr. 2838 Prot., datë 30.09.2024 është shprehur “...projektvendimi është në përputhje me Vendimin e Gjykatës Kushtetuese me nr. 38/ 2022, por pavarësisht kësaj përputhëmie, *kushtet dhe dokumentacioni i kërkuar që shtetasit shqiptarë me banim jashtë vendit të realizojnë të drejtën për të votuar, janë të shumta dhe pjesërisht jo vetëm të panevojshme, por edhe të porealizueshme, duke vënë në dyshim realizimin efektiv, të plotë, të saktë të ushtrimit të kësaj të drejte.*”, në këtë relacion është sqaruar se nevoja për të përcaktuar një listë dokumentacioni është parashikuar në nenin 25 pika 5 të KZ, e përsa na takon KQZ është munduar të ofrojë një gamë të gjerë dokumentash për t’i ofruar zgjedhësit të gjitha mundësitë sa i takon larmishmërisë së dokumentacionit që do të pranohet si i vlefshëm për deklarin e adresës.

Në opinionin e saj Qëndresa Qytetare, të ardhur me shkresën nr. 2822 Prot., datë 30.09.2024 është shprehur “...Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përmes propozimit të Komisionerit e ka kufizuar edhe më tej të drejtën e votës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke pranuar si dokumente që mund të sigurohen nga shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të RSH në mënyrë të rregullt, që lidhen me statusin e migrimit të shtetasve”. Një pjesë e konsiderueshme e shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë kanë status migrimi të paligjshëm, si rrjedhojë nuk mund të sigurojnë kontrata, si ato të qirasë, furnizimit me energji elektrike, ujë apo shërbime internet, të kenë certifikata pronësie apo kontrata kredie bankare”. “..të gjithë dokumentet që parashikohen të përfshihen në listën e dokumentacionit që provon qëndrimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, janë dokumente në gjuhë të huaj, përmbajtja e të cilave nuk mund të verifikohet pa iu nënshtruar më parë përkthimit..apo duhet të shoqërohen më certifikatën “Apostille”; Qëndresa qytetare gjithashtu parashtron se “Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Komisioni Rregullator, të pranojnë si të mjaftueshme për vërtetimin e qëndrimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë edhe vetëdeklarimin e zgjedhësit mbi adresën e saktë të banimit, kundrejt njoftimit të pasojave ligjore që vijnë në rast të deklarin të pasaktë ose të rremë, sipas Formatit që i bashkëlidhet këtij vendimi”; Në lidhje me sugjerimet e Qëndreses Qytetare për t’u shtuar “vetëdeklarimim e zgjedhësit mbi adresën e saktë të banimit” në listën e dokumentacionit që vërteton qëndrimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, shpjegojmë se nuk mund të pranohet pasi është kërkesë e Kodit Zgjedhor që zgjedhësi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të ketë dokumentacionin për deklarin e adresës së tij jashtë territorit të Republikës

së Shqipërisë dhe e njëjta logjikë aarrsyetimi si në rastin e propozimit të Komitetit Shqiptar të Helsinkit shpjeguar më lart vlen edhe në këtë rast.

Në opinionin e saj zj. Anila Smorgrav, përfaqësuese e KKD parashtron në lidhje me listën e dokumentacionit për të vërtetuar qëndrimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë sugjeron ...*“pranimin e një deklaratë nga ambasada ose konsullata shqiptare si provë e banimit për të mos penalizuar një grup shtetasish që mund të mos kenë mundësi të dokumentave zyrtare të vendit”*. Ezauruar parashtrimi si më lart në rastin e opinioneve për dokumentet e shpjeguara më sipër.

Për sa më lart, në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në Ligjin nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i propozon për shqyrtim dhe miratim Komisionit Rregullator projektvendimin, “Për miratimin e listës së detajuar të dokumentacionit që kërkohet për regjistrimin e zgjedhësve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

**Jona JOSIFI - Drejtorja e Votimit nga Jashtë**

**Pavlina DOÇAJ - Drejtorja e Ligjshmërisë**

**Majlinda ÇELMETA – Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)**

**Ilirjan Celibashi**

**Komisioner Shtetëror i Zgjedhjeve**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONI RREGULLATOR

Tiranë më	protdate
Nr.	protnumber

Data: DD MM VVVV

Nr:000-000

Ora: HH:MM

PROJEKT VENDIM

PËR

**MIRATIMIN E LISTËS SË DETAJUAR TË DOKUMENTACIONIT QË KËRKOHET  
PËR REGJISTRIMIN E ZGJEDHËSVE QË VOTOJNË JASHTË TERRITORIT TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË.**

Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja “dh”, nenit 25, pika 5 të Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I:

**I. Rregulla të përgjithshme**

1. Zgjedhësi për regjistrim në listën e zgjedhësve jashtë vendit paraqet dokumentacion që vërteton qëndrimin e tij jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
2. Adresa e shtetasit që voton nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë mbështetet në një nga dokumentet që paraqet në KQZ sipas pikës 5 të nenit 25 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Të dhënat e identitetit të shtetasit kërkohen të verifikohen nga KQZ-ja në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile dhe, nëse ato janë të njëjta, bëhet nga DPGJC-ja regjistrimi në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile i adresës së shtetasit që voton jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në një rubrikë të veçantë.

**II. Lista e detajuar e dokumentacionit që kërkohet për regjistrimin e zgjedhësve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë**

1. Gjatë paraqitjes së kërkesës së tij për regjistrim në listën e zgjedhësve jashtë vendit sipas rregullave të miratuara nga Komisioni Rregullator, zgjedhësi ngarkon në Platformën Elektronike të

Data: dd mmvvvv Nr: 000-000



Për miratimin e listës së detajuar të dokumentacionit që kërkohet për regjistrimin e zgjedhësve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Regjistrimit (PER) të paktën një nga dokumentet e listuar më poshtë që vërteton qëndrimin e tij jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë:

- i. certifikatë pronësie ose dokument ekuivalent në shtetin e rezidencës që provon pronësinë e banesës;
- ii. vërtetim banimi ose dokument tjetër ekuivalent i lëshuar nga organe shtetërore të vendit të rezidencës, ku përcaktohet adresa e banimit.
- iii. kontratë qiraje ose huapërdorje të banesës;
- iv. kontratë kredie për blerje të banesës;
- v. kontratë furnizimi ose faturë të furnizimit me ujë në banesë;
- vi. kontratë furnizimi ose faturë të energjisë (gaz ose elektrike) në banesë;
- vii. kontratë ose faturë të abonimit të shërbimit digjital të transmetimeve audiovizive;
- viii. kontratë ose faturë të ofrimit të shërbimit të internetit/telefonisë fikse në banesë;
- ix. dokument të lëshuar nga organi kompetent i shtetit ku ka vendbanimin, i cili vërteton qëndrimin e zgjedhësit në një institucion shëndetësor, kamp emigracioni, apo tjetër të ngjashëm;

## VI. Dispozita të fundit

1. Ngarkohet administrata e KQZ-së dhe institucionet e ngarkuara me detyra nga ky vendim, me zbatimin e tij.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, brenda (5) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**